



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 369/1 Prot.

Tiranë, më 17.02.2026

V E N D I M

Nr. 32, Datë 17.02.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është regjistruar ankesa me nr. 35, datë 03.02.2026, e paraqitur nga znj. M.Ç kundër Ministrisë së Arsimit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin e vajzës së mitur V.Ç, për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “Jam nëna e 3 fëmijëve të cilët frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, përkatësisht në klasën e parë, të pestë dhe të nëntë. Jam person me AK, pasi trajtohem me paaftësi nga Bashkia, në shumën 8.958 lekë. Po u drejtohem ju si institucion për shkak të problematikës që kam në lidhje me mospërfitimin e bursës për njërën nga vajzat e mija. Më poshtë po u shpjegoj situatën:

¹ Referuar Vërtetimit datë 07.10.2025, të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, vërtetohet se M.Ç trajtohet me pagesë paaftësie me nr. dosje 594.

Në muajin tetor 2025 lajmërohem nga mësueset e fëmijëve për të përgatitur dokumentacionin lidhur me përfitimin e bursës, në bazë të VKM 666, datë 10.10.2019, për të tre vajzat e mija, pasi siç e përmenda më lart jam person me AK dhe bashkëshorti im trajtohet me ndihmë ekonomike. Pasi përgatita dokumentacionin përkatës (si përfituese në pikat 2.1 dhe 2.3/d), i dorëzoj pranë shkollës për të 3 vajzat e mija, ku nga këto të fundit pajisem dhe me procesverbalin ku shënohet që dokumentacioni i dorëzuar është i rregullt.

Në muajin dhjetor mësueset përkatëse më lajmërojnë që 2 vajzat e mija janë përfituese kurse e treta jo. Kërkoj shpjegim se cila është arsyeja e mospërfitimit të bursës për vajzën dhe nga ana e mësueses kujdestare më thuhet që nuk është në dorën time, por e ka Bashkia.

Paraqitem pranë NSHMAÇ ku kontaktoj një prej punonjësve të saj, e cila më shpjegon lidhur me situatën në të cilën thekson që dokumentacioni është i rregullt, por edhe pse është brenda afatit kohor ky fëmijë nuk është përzgjedhur, pasi janë marrë në konsideratë të gjitha dokumentet e dorëzuara deri në datën 17 tetor 2025 (ku në to futen dhe emrat e dy vajzave të mija, pasi në procesverbal ato mbajnë data të ndryshme para datës 17 tetor, kurse e treta është në datën 20 tetor, edhe pse unë i kam dorëzuar të gjitha në një ditë). Nuk e di se çfarë ka ndodhur me datat në procesverbale ngaqë numri i kërkesës ka qenë shumë më i lartë nga numri i bursave të ofruara nga MAS dhe Bashkia ka mbuluar një pjesë të tyre, por në pamundësi për të gjithë ka kërkuar përsëri nga MAS rritjen e numrit të kuotave, kjo nëpërmjet një shkrese dërguar nga ky institucion. Problemi qëndron dhe në diçka tjetër, nga fjala që mësuesit më thanë, se të janë trajtuar dy dhe e treta jo, ndërkohë që i gjithë dokumentacioni është dorëzuar në të njëjtën kohë. Pse duhet të ndodhë ky diskriminim për njërën nga vajzat?”.

Ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për vajzën e saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, afhtësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore

të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

- Me shkresën nr. 267/1, datë 05.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e ankueses, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion mbi arsyet se përse nuk është pranuar aplikimi/dokumentacioni i paraqitur nga pala ankuese për përfitimin e bursës për fëmijët.
 - Kopje të dosjes të dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja për të tre fëmijët.
 - Informacion nëse fëmijët kanë qenë përfitues të bursës në vitet e mëparshme shkollore.

Nga verifikimet e kryera rezulton se pretendimet e parashtruara nga ankuesja, po shqyrtohen nga KMD, dhe në kuadër të ankesës nr. 29, datë 26.01.2026, për të cilën Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është në proces të trajtimit të kësaj ankese.

Për sa më sipër, Komisioneri, mbështetur në nenin 33, pika 4/c e LMD, të ndryshuar, i cili përcakton se: *“Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*, gjykon se pretendimi i ankueses për diskriminim nga Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë nuk mund të pranohen për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 4/c, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 35, datë 03.02.2026, të paraqitur nga znj. M.Ç kundër Ministrisë së Arsimit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, pasi e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA